



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHOQËRIA RAJONALE
UJËSJELLËS KANALIZIME DURRËS SH.A

Durrës më ____ . ____ .2023

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“SIGURIMI ASETËVE”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

SHËRBIME TË SIGURIMIT 79710000-4

FONDI LIMIT:

29,800,000 (Njëzet e nëntë milion e tetëqind mijë) Lekë pa TVSH.

Argumentimi: Perlllogaritja e vleres se fondit limit eshte bere referuar Nenit 35 te ligjit nr.162/2020, si dhe nenit nr.13 dhe nenit nr.76 te VKM 285 date 19.05.2021.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3.;

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës 9

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Sipas Formularit përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës 9

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, si dhe në nenin 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar

(shënim: *plotësoni nëse është rasti, aktin konkret ligjor ose nëligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale në fjalë*).

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2020, 2021 dhe 2022, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet . *Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 3 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, *”Ne lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetit ose entet*

2

kontraktore mund te vendosin kërkesa qe garantojme qe operatorët ekonomike kane kapacitetin e nevojshem ekonomik dhe financiar për te zbatuar kontraten”, ”Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës”, si dhe bazuar ne nenin 43, pika 2/b, nenin 55 pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: c) vlerën e parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar.

Vendosja e ketij kriteri kualifikues i sherben Autoritetit Kontraktor per te vertetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron te gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare per te permbushur me sukses kontraten.

Duke marre ne konsiderate vleren e fondit limit te kesaj procedure prokurimi, kërkohet qe OE ofertues te paraqesë se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për ta realizuar atë ne kohe dhe ne përputhje me specifikimet teknike te kërkua. Për ketë, OE ofertues duhet te ketë disponibilitetin e duhur ekonomik dhe me këtë qellim, është argumentuar se vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vleres se fondit limit dhe vendosja e ketij limiti nuk kufizon pjesemarrjen e operatorëve ekonomike.

Përcaktimi i viteve të kërkua për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2020, 2021 dhe 2022, të certifikua nga autoritetet përkatëse (Dega e Tatim Taksave) ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkua për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjisllacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të ketij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën

kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, **në një vlerë jo më të vogël se 40 %** të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate. *(apo shumatores së fondit limit të loteve, nëse kontrata është e ndarë në lote dhe ofrohet për më shumë se një lot).*

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 3 *(ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b)*, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.3.2 Ofertuesi duhet të jetë kompani sigurimesh e pajisur me leje për ushtrim të aktivitetit sigurime dhe/ose risigurime nga Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare, ku të jenë specifikuar qartë grupet /klasat për sigurimet e kërkuara në këtë tender. Përfshihen nga kjo procedurë Brokerat dhe agjentët e sigurimeve.

Argumentimi: Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku parashikohet se: ”Për të provuar

përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga organet kompetente shtetërore, si dhe mbështetur ne Ligjin me Nr 52/2014 Per veprimtarine e Sigurimit dhe Risigurimit.

2.3.3 Ofertuesi duhet të ketë ne veprimtarine e tije klasat 8 dhe 9 te cilat vertetohen ne dorezimin e Licenses se Ushtrimit te Veprimtarise te Sigurimit e shoqeruar me aneksin perkates e leshuar nga Autoriteti i Mbikqyrjes Finaciare, ku perfshihen klasat perkatese te sigurimi.

Argumentimi: Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku parashikohet se: ”Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga organet kompetente shtetërore, si dhe mbështetur në Ligjin me Nr 52/2014 Per veprimtarine e Sigurimit dhe Risigurimit.

2.3.4 Ofertuesi duhet te kete kontratë risigurimi për periudhën kohore në të cilën ofertuesi merr përsipër sigurimin e dëmit që kërkohet në këtë procedurë prokurimi.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,i ndryshuar, Si dhe mbështetur në rregulloren me Nr 85/1 date 30.09.2015 I ndryshuar

2.3.5 Niveli i Risigurimit duhet te jete A+ dhe te vertetohet me dorezimin e kontrates te risigurimit ne te cilen shprehet dhe niveli i risigurimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,i ndryshuar, si dhe referuar Ligjit 10448 date 14.07.2011 “Per lejet e mjedisit” dhe neni 53 te Ligjit 10463 date 22.09.2011 “Per menaxhimin e integruar te mbetjeve”,si dhe mbështetur në rregulloren me Nr 85/1 date 30.09.2015 I ndryshuar.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit

publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

TERMAT E REFERENCËS

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve
Sigurimi i aseteve

Rreziqet që kërkohen të mbulohen nga polica e sigurimit

1. Rreziku nga zjarret.
2. Rreziku nga shpërthimet.
3. Rreziku nga stuhitë.
4. Rreziku i forcave të natyrës
5. Rreziku i shkarjes së tokës
6. Rreziku i rënies së avionëve, pjesëve ose ngarkesave të tyre mbi pasurinë e siguruar të Shoqërisë.

- Sigurimi duhet të marrë përsipër mbulimin total të dëmit të ndodhur si pasojë e një ngjarje sigurimi nga rreziqet e mësipërme.
- Sigurimi është përgjegjës për mbulimin e kostos së riparimit të dëmit të ngjarjes së ndodhur duke kthyer asetin e dëmtuar në gjëndjen e mëparshme brenda një periudhe kohore 30 ditore.

a. Sigurimi nga rreziku i zjarrit dhe rreziqet shtesë që shoqërojnë atë.

- Zjarr do të konsiderohet të jetë një formë e djegjes me flakë e të mirave material, e aftë të vetëpërhapet dhe të vetëzgjerohet. Ky përkufizim përfshin cdo formë të lindjes dhe krijimit të zjarrit që prek objektet e siguruar nga zjarri.
- Rrufe do të konsiderohet të jetë një shkrepje e shkarkesë elektrike e cila godet një objekt direkt ose indirect.

- Eksplozion do të konsiderohet të jetë një çlirim i papritur i energjisë i shkaktuar nga forca e gazrave ose avujve në përpjekje për zgjerim. Në se shkak për shpërthimin brenda enës është një reaksion kimik, atëherë do të dëmshpërblehet cdo dëmtim i enës dhe në se paretet e saj nuk janë shkatërruar.
- Rënie avionësh ose pjesë të tij mbi objektet e siguruara.

b. Sigurimi nga rreziku i tërmetit dhe rreziqet shtesë që e shoqërojnë atë.

- Tërmeti duhet të jetë i regjistruar nga Stacionet Sizmike, si dhe të ketë një vlerë jo më të vogël se 4 ballë sipas shkallës Rihter.

c. Sigurimi nga rreziku i stuhisë dhe rreziqet shtesë që shoqërojnë atë.

- Stuhi do të konsiderohet një lëvizje ajri me forcë jo më të vogël se 6 ballë (17.2 m/sek. ose 62 km/orë) shkaktura nga kushtet meteorologjike. Në qoftë se nuk ka matje nga stacionet meteorologjike që kjo forcë e re mbizotron kur ndodh një ngjarje, do të jetë e mjaftueshme në qoftë se i Siguruari sjell të dhëna. Kompania Siguruese do të paguaj dëmshpërblimin për objektet e siguruara, të cilat janë shkatruar ose dëmtuar nga stuhia.
- Shkatrimi ose dëmtimi që do të shkaktohet nga ndikimi direkt i stuhisë.
- Shkatrimi ose dëmtimi që do të shkaktohet nga stuhia, duke hedhur pjesë të ndërtesës, pemë ose objekte të tjera brenda objekteve të siguruara ose ndërtesës në të cilën janë vendosur objektet e siguruara.
- Është pasojë e humbjes ose dëmit të shkaktuar nga stuhia, në objektet e siguruara ose në elementë të këtyre objekteve.

d. Sigurimi nga rreziku i përmbytjeve dhe rrëshqitjes së tokës

Ky sigurim mbulon humbjen ose demin për shkak të rrëshqitjes së sipërfaqes së tokës në zona të pjerrëta, me plasaritje dhe çarje në formë damarësh, që shihen qartë, të cilat në periudha të shkurtra kohe shkaktojnë deformacione statike të rrezikshme ose çarje të mëdha në ndërtesat.

Shpërndarja: Sipas listës së objekteve bashkelidhur

Specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, janë në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,

Kujdes:Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Grupi I hartimit të specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim